



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3730/12 Prot.

Tiranë, më 06.12 2024

V E N D I M

Nr. 80 dt. 06.12 2024

“PËR
HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIMIN PËR ANËTAR
TË KOMISIONIT TË PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK TË
UST-së (KPPA)”

Në zbatim të pikës 1 (gërma “i”) të nenit 38, të pikës 3 dhe 5 të nenit 46 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, i ndryshuar, VKM-së nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” i ndryshuar; gërmës “nj” të nenit 20 si dhe neneve 26, 27 të Statutit të UST-së, për krijimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si strukturë përgjegjëse për dhënien e titujve “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.12.2024,

V E N D O S I:

1. Hapjen e thirrjes për vetëkandidimin për anëtar të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së (KPPA), thirrja bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sekretaria e Senatit Akademik dhe Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për zbatimin dhe publikimin e këtij Vendimi dhe thirrjes.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Lënda: Njoftim mbi vetëkandidimin për anëtar të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik

Në zbatim të pikës 1 (gërma “i”) të nenit 38, të pikës 3 dhe 5 të nenit 46 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, i ndryshuar, VKM-së nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” i ndryshuar; gërmës “nj” të nenit 20 si dhe neneve 26, 27 të Statutit të UST-së, për krijimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si strukturë përgjegjëse për dhënien e titujve “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”,

Ftoheni të vetëkandidoheni për të qënë anëtarë të këtij komisioni, nëse plotësoni kriteret e përcaktuara në pikën 4 të nenit 27 të Statutit të UST-së. Rregjistrimin mund ta bëni në zyrën e Protokoll-Arkivës së UST-së, nga data 06.12.2024 deri brenda orës 15:30 të datës 18.12.2024.

Mbetemi në pritje të vetkandidimeve tuaja, në mënyrë që në mbledhjen e radhës, të Senatit Akademik, të përzgjidhen anëtarët, që do të formojnë Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AGRON KASA